



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E PEJËS
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Pejës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Edon Kabashi* udhëheqës i ekipit, *Ylber Sadiku* dhe *Hysen Restelica* anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Faruk Rrahmani*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Qeverisja e mirë.....	30
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	32
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	39
Shtojca II: Letër Konfirmim	42

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 21/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se pasuritë jo financiare në Pasqyrat Financiare Vjetore nuk ishin prezantuar drejt pasi që në njëren anë ishin të nënvlerësuara për 278,654€ ndërsa në anën tjetër ishin të mbivlerësuara për 685,000€.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:

Theksimi i Çështjes pasqyron dobësitë në kontrolle për ta konfirmuar regjistrimin e pasurisë saktë dhe shpalosjen e drejtë dhe të plotë në PVF.



Kryetari duhet t'i analizojë arsyet për Theksimin e Çështjes në 2018 dhe t'i identifikoj veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë në 2019, si dhe shpalosje të plota. (shih çështjet te kapitulli 2).

Kontrollet në menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, obligimeve, llogarive të arkëtueshme në fushën e prokurimit nuk kanë funksionuar si duhet prandaj nuk kanë mundur t'i parandalojnë mangësitë në këto fusha.



Kryetari duhet të aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe të përcaktoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet te kapitulli 3).

Përkundër progresit ende mbetet sfidë adresimi i plotë i rekomandimeve të vitit paraprak duke penguar zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Kryetari duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar se rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet te kapitulli 5).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë të dobëta.



Kryetari duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për ta ngritur efektivitetin operativ (shih çështjet te kapitulli 4).

Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Komunës së Pejës.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Pejës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Komuna nuk kishte regjistruar 11 pagesa të investimeve kapitale në vlerë prej 278,654€ në regjistrin e pasurive kapitale. Pagesat përfshijnë: asfaltimin e rrugëve në fshatrat Jabllanicë e Leshanit, Kliqinë dhe Leshan 90,000€; ndërtimi i shkollës së muzikës 73,183€; ndërtimi i shtëpisë për qëndrim ditor për individët e moshës së tretë 30,059€; ndërtimi i shkollës së mesme të artit 26,345€; zgjerimi i kapaciteteve për ngritjen dhe ruajtjen e mjedrës 17,161€; ndërtimi i parketit në palestrën e sporteve Karagaq 15,000€; ndërtimi i palestrës sportive Vitomericë 11,630€; kubëzimi, gjelbërimi dhe ndriçimi në lagjen Puhovc 10,000€, si dhe disa pagesave me vlerë prej 5,276€; dhe
- Komuna ka regjistruar gabimisht dy pagesa në vlerë prej 685,000€ të investimet në vijim dhe si pasojë regjistri i pasurive është mbivlerësuar për këtë vlerë. Pagesat janë bërë nga Komuna për KUR "Hidrodrini" nga kodi i transfereve kapitale për financimin e projektit që ka të bëjë me ndërtimin e Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza¹. Arsyeja pse Komuna nuk duhet të bëjë regjistrimin si investim në vijim lidhet me faktin që pagesa është bërë nga kodi i transferit kapital dhe fondet janë derdhur në llogarinë bankare të KUR "Hidrodrini" si përfituese e projektit dhe komuna nuk bën pagesa direkte ndaj operatorëve ekonomik. Për më tepër ndërtimi i impiantit ende nuk ka filluar dhe regjistrimi i kësaj pasurie pas ndërtimit duhet të bëhet nga përfituesi.

Kjo gjendje ishte për shkak se një pjesë e pagesave ishin në fund të vitit por edhe si rezultat i neglizhencës dhe mungesës së njohurive të zyrtarit të pasurive lidhur me kërkesat e rregullores së pasurive.

Opinionin jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar

¹ Participim me KFW në projektin për ndërtimin e Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza 595,000€ dhe 90,000€. Qëllimi i projektit është përmirësimi i grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza në qytetin e Pejës. Përfituese dhe implementuese e projektit është KUR "Hidrodrini". Kostoja e Projektit është 25 mil.€. Shpenzimet do të financohen nga KFW Development Bank prej 9 mil€, nga SECO me 7.6 mil.€, nga Komuna e Pejës me 3 mil.€, nga një kontribut lokal në natyrë (tokë/tokë-përdorim-të drejtat) nga komuna me një vlerë të parashikuar prej 1.6 milion euro dhe 3.8 milion euro nga fondet e ardhshme të BE-së ose nga kontributet lokale nga MMPH.

në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike dhe 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Planin fillestar dhe final të prokurimit; dhe
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal.

Komuna e Pejës nuk kishte bërë barazime me thesar në Ministrinë e financave për shkak se kishte një avancë të pambyllur. PVF-të nuk ishin subjekt i një niveli të duhur të shqyrtimit nga menaxhmenti. Të dhënat në PVF-të e Komunës ishin të nënvlerësuara krahasuar me të dhënat e SIMFK-së të cilat i prezantojmë në vijim:

Në nenin 14 - shënimi 3, mallra dhe shërbime - vërehet se në kolonën e buxhetit final kemi një diferencë në mes të dhënave të SIMFK-së dhe PFV-ve për 46,000€;

Në nenin 14 - shënimi 6, investime kapitale - vërehet se në kolonën e buxhetit final kemi një diferencë në mes të dhënave të SIMFK-së dhe PFV-ve për 66,973€. Po ashtu, te kolona e realizimit kemi një diferencë në mes të dhënave të SIMFK-së dhe PFV-ve për 35,387€; dhe

Në nenin 18 - shpalosja e detyrimeve kontingjente - vërehet se ishin të mbivlerësuara për 82,081€. Gjatë testimeve të pagesave është verifikuar se kjo vlerë e detyrimeve ishte paguar përderisa në PFV akoma figuronte si detyrim kontingjent.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura rekomandojmë:

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Të gjitha pasuritë jo financiare, duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë, ndërsa pasuritë të cilat nuk janë në pronësi të Komunës duhet të largohen nga regjistrat për të shmangur mbivlerësimin e tyre. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që në PFV-të e vitit 2019 adresohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me gabimet financiare të identifikuara.

Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Pejës kishte shpenzuar 97% të buxhetit final për vitin 2018 që nënkupton një realizim shumë të mirë. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në arkëtimin e të hyrave në nivel më të lartë dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe.

Gjithashtu, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar keq klasifikimin e shpenzimeve, angazhimin e punonjësve me kontrata të përkohshme, anashkalimin e rregullave të prokurimit, rritjen e pagesave me vendime gjyqësore dhe vonesave për përfundimin e projekteve kapitale.

Me tutje, komuna duhet të ndër marrë veprime për të përmirësuar menaxhimin dhe raportimin e plotë të pasurive dhe obligimeve, çështje këto të ngritura edhe në raportin e vitit paraprak.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	24,554,896	25,473,230	24,804,412	23,082,882	22,047,434
Granti i Qeverisë - Buxheti	20,455,234	20,799,254	20,777,770	18,027,839	17,496,799
Të bartura nga viti paraprak ³	-	225,064	224,264	1,060,824	728,484
Të hyrat vetjake ⁴	4,066,262	4,066,262	3,546,914	3,384,644	2,841,727
Donacionet e brendshme	-	43,063	17,591	194,279	472,244
Donacionet e jashtme	-	261,489	237,873	415,296	508,180
Financimi nga huamarrja e jashtme	33,400	78,098	-	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 918,334€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të brendshme dhe të jashtme për 304,552€, të hyrave të bartura nga viti paraprak për 225,064€, financimit nga huamarrja e jashtme për 44,698€ dhe grantit qeveritar për 344,020€.

Në vitin 2018, Komuna ka shpenzuar rreth 97% të buxhetit final ose 24,804,412€, me një përmirësim për 2% krahasuar me vitin 2017 (95%).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	24,554,896	25,473,230	24,804,412	23,082,882	22,047,434
Pagat dhe Mëditjet	13,924,067	13,775,408	13,644,056	13,219,353	13,213,466
Mallrat dhe Shërbimet	2,853,380	2,888,888	2,834,090	2,407,120	2,559,607
Shërbimet komunale	701,924	707,711	706,618	683,863	664,499
Subvencionet dhe Transferet	300,000	302,250	300,260	286,808	248,570
Investime kapitale	6,775,525	7,798,973	7,319,388	6,485,738	5,361,292

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake

- Reduktimi i buxhetit final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte për 148,659€. Ky zvogëlim ka ardhur me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte rreth 99%;
- Rritja e buxheti final për mallra dhe shërbime 35,508€, shërbime komunale 5,787€ si dhe subvencione dhe transfere 2,250€. Realizimi i buxhetit për mallra dhe shërbime ishte 98%, shërbime komunale 100% ndërsa në kategorinë subvencione dhe transfere rreth 99% po ashtu; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,023,448€. Rritja prej 500,000€ për financimin e shpronësimeve ka ndodhur me vendim të Qeverisë, kurse rritja tjetër ka ardhur nga të hyrat vetanake dhe të granteve të përcaktuara të donatorëve. Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit 2018, afër 94% e buxhetit ishte shpenzuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna ishin në vlerë 3,589,495€. Të hyrat janë realizuar nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja, etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 ⁵ Pranimet
Të hyrat vetjake	4,066,262	4,066,262	3,589,495	3,051,922	3,016,853

Prej gjithsej të hyrave vetjake të planifikuara, komuna kishte arritur të inkasoj 88%, dhe vërehet një trend pozitiv në arkëtimin e të hyrave nëpër vite.

Përpos të hyrave të prezantuara në tabelë komuna kishte edhe të hyra indirekte nga dënimet në trafik në vlerë prej 659,472€. Këto ishin nga dënimet në trafik 556,258€, gjobat e gjykatave 103,207€ dhe të hyrat nga pyjet 7€.

⁵ Pranimet për vitin 2016 përfshijnë edhe të hyrat indirekte.

Çështja B1 - Menaxhim jo adekuat i pronave komunale të dhëna me qira

Gjetja Sipas Ligjit 04l/144, dhënia e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim bëhet përmes konkurrencës së hapur publike. Komuna nuk kishte një data bazë të saktë dhe të plotë të pronave të dhëna me qira. Na janë ofruar lista të ndryshme ku njëra kishte 42 prona me qira, kurse tjetra kishte 29 prona me qira. Këto prona ishin dhënë pa ankand me përjashtim të një prone që në vitin 2018 ishte dhënë me ankand.

Në tri raste nuk kishte informata në lidhje me kohën e dhënies me qira dhe afatin e skadimit të kontratave.

Rreziku Mungesa e kontrollit përfshirë një data bazë të pronave të dhëna me qira dhe operimi pa kontrata privon komunën nga e drejta për arkëtimin e të hyrave dhe ndjekjen e proceduarave gjyqësore në raste të mos arkëtimit të borxhit me kohë.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe të siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale të bëhet vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave.

Çështja A2 - Parregullsi në menaxhimin e tatimit në pronë

Gjetja Ligji mbi tatimin në pronë nr. 03/L-204, në nenin 9, përcakton që çdo pronari (personi) i lejohet zbritja prej 10,000€ nga vlera e tatueshme e pronës primare (kryesore). Ne kemi identifikuar nëntë (9) raste, ku nuk ishte respektuar kjo kërkesë ligjore, duke aplikuar zbritjen prej 10,000€, për dy apo më tepër prona të regjistruara si banim kryesor për të njëjtin tatimpagues. Me aplikimin e ligjit të ri mbi tatimin në pronë nga janari 2019 ka një progres në këtë fushë pasi ka filluar vendosja e numrit identifikues të pronarit, që e parandalon përfitimin në më shumë se një pronë. Mbetet në të ardhmen të verifikohet nëse të gjitha pronat janë regjistruar sipas numrit identifikues.

Mangësitë e tilla kanë rrjedhur nga fakti që identifikimi i pronarëve është bërë në bazë të emrit dhe mbiemrit e ku me të njëjtin emër dhe mbiemër kishte shumë pronarë. Po ashtu kjo ka rezultuar edhe për shkak të neglizhencës së zyrtarëve për verifikimin e saktë të pronave.

Rreziku Mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore të tatimit në pronë rrit rrezikun që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta dhe të ketë një trajtim jo të drejtë të pronarëve karshi rregullave ligjore.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj përmes drejtorit të tatimit në pronë se të gjithë pronarët në data bazën e sistemit janë regjistruar sipas numrit identifikues dhe të ndërmarrë veprime shtesë që kjo të bëhet sa më shpejt duke i eliminuar gabimet në procesimin e të dhënave.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë më: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin më thesar.

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 13,775,408€. Prej tyre ishin shpenzuar 13,644,056€ apo rreth 99% e buxhetit të planifikuar.

Çështja B2 - Menaxhim jo adekuat i dosjeve të personelit

Gjetja Komuna nuk kishte arritur ende të kompletoj dosjet e personelit në përputhje me Rregulloren Nr. 03/2011 mbi dosjet dhe regjistrin për shërbyesit civil dhe dosjet në sektorin e arsimit. Ne kemi vërejtur se:

- Dosjeve të shërbyesve civil, në katër raste ju mungonin dokumentet si: çertifikata e shtetësisë dhe vendbanimit, çertifikata nën hetime, vërtetimi i përvojës së punës, formulari i vlerësimit të performancës, dhe dëshmi tjera që kërkohen të jenë pjesë e dosjeve të personelit; dhe
- Në dosjet e punonjësve të arsimit, në katër raste mungonte vlerësimi i performances, kërkesë kjo e UA nr.14/2013 të Ministrisë së Arsimit.

Mangësitë ishin të shkaktuara kryesisht nga neglizhenca dhe pakujdesia në plotësimin dosjeve.

Rreziku Mos azhurnimi i dosjeve dhe mos kompletimi me dokumentacionin e nevojshëm, rrit rrezikun për menaxhimin jo adekuat të stafit dhe reflekton me parregullsi dhe mungesë të informatave për stafin e punësuar.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë hapa konkret për përmirësimin e kontroleve mbi dosjet e personelit, në mënyrë që të gjitha dosjet të jenë kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm, deri në fund të vitit me qëllim të menaxhimit të stafit.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime/komunale ishte 3,596,599€. Prej tyre ishin shpenzuar 3,540,708€ apo rreth 98% e buxhetit të planifikuar. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për komunali, udhëtim, telekomunikim, blerje e pajisjeve, derivate dhe lëndë djegëse, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit, mirëmbajtje, dhe dreka zyrtare.

Çështja C1 - Mangësi në menaxhimin e angazhimit përmes kontratave të përkohshme

Gjetja Komuna gjatë vitit 2018 kishte të angazhuar 51 punonjës. Prej tyre 6 janë angazhuar me Ligjin e Punës dhe 45 prej tyre ishin me marrëveshje për shërbime të veçanta (MSHV) bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil.

Në 45⁶ raste angazhimet me MSHV ishin bërë pa ndonjë procedurë të thjeshtuar të rekrutimit, përkundër që neni 12 i Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përcakton se emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj duhet bërë me procedura të thjeshtuara të rekrutimit. Po ashtu, vërehet se stafi ishte i angazhuar kryesisht për pozita të rregullta⁷ të punës.

Sipas zyrtarëve komunal, mangësitë e identifikuara, janë pasojë e mungesës së buxhetit për staf të ri për programet e përhershme dhe aprovimit të kufizuar të vendeve të punës nga Ministria e Financave (MF) krahasuar me kërkesat.

Rreziku Mbulimi i pozitave me marrëveshje të përkohshme pa procedura rritë rrezikun nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi adekuat dhe mund të rezultojë me performancë të dobët dhe mos arritje të objektivave.

Rekomandimi C1 Kryetari, duhet të siguroj ndërprerjen e një praktike të tillë të angazhimeve pa procedura të rekrutimit. Po ashtu, komuna për pozitat e rregullta të punës për të cilat ka nevoja afatgjata kërkesat t'i adresoj me rastin e planifikimit buxhetor, dhe t'i trajtoj dhe diskutoj me MF.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 302,250€. Prej tyre ishin shpenzuar 300,260€ apo rreth 99% e buxhetit të planifikuar. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve kulturore, sportive dhe ndihma momentale.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 7,798,973€. Prej tyre ishin shpenzuar 7,319,388€ apo afër 94% e buxhetit të planifikuar. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime për rregullim të infrastrukturës, ndërtim i rrugëve, kanalizimit, trotuareve, ndërtim dhe mirëmbajtja e objekteve, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të pasurive kapitale.

⁶ Gjashtë punonjësit me ligj të punës dhe 39 me ligj të shërbimit civil janë angazhuar pa procedura të rekrutimit.

⁷ Zyrtar Ligjor, vozitës, zyrtar të IT-së etj.

Çështja A3 - Keq klasifikimi i shpenzimeve kapitale

Gjetja Ligji Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike. Ne kemi identifikuar pesë raste në të cilat kishte pasur keq klasifikim të shpenzimeve kapitale kryesisht për shkak të keq buxhetimit si :

- Nga investimet kapitale ishin paguar 4,752€ për furnizimin me 10 aparate oksigjeni për QKMF. Po ashtu, për furnizim me pelet ishin paguar 1,000€, dhe 612€ për furnizimin me kompjuter. Këto furnizime për nga natyra i takojnë mallrave dhe shërbimeve;
- Nga investimet kapitale ishin paguar 17,353€ për blerjen e makinave për mjeljen e lopëve për fermerët e komunës ndonëse natyra e kësaj pagese ishte e natyrës së subvencioneve; dhe
- Nga investimet kapitale ishin paguar 73,068€ sipas vendimit gjyqësor/përmbarrimor - për dëmshpërblimin e një nxënëse e cila kishte pësuar lëndime fizike/psikike nga shpërthimi i kalldatores së ngrohjes qendrore në një shkollë fillore.

Sipas zyrtarëve të komunës, arsyeja ishte se ndarjet buxhetore në kategorinë e mallrave/shërbimeve dhe subvencioneve ishin tejte të ulëta ndërsa nevojat e mëdha.

Rreziku Planifikimi jo i duhur i ndarjeve buxhetore sipas nevojave, ka ndikuar keq klasifikimin. Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se është bërë planifikimi i drejtë i buxhetit sipas nevojave dhe të sigurojë se në PIP vendosën vetëm ato projekte kapitale për të cilat sigurohet se kanë të bëjnë me përvetësimin e pasurisë për nevojat e komunës. Planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.

Çështja A4 - Mangësi në çertifikimin e pagesave dhe menaxhimin e kontratave

Gjetja Në tre raste kemi evidentuar mangësi në çertifikimin e pagesave, dhe menaxhimin e kontratave si në vijim:

- Në pagesën prej 19,913€ për mirëmbajtjen e shkollave kemi evidentuar se montimi i kalldasë për ngrohje në vlerë prej 900€ ishte faturuar dhe paguar në dy herë. Pas trajtimit tonë është korrigjuar gabimi financiar;
- Në pagesën prej 73,182€ për “Ndërtimin e shkollës së muzikës Halit Kasapolli” kemi evidentuar se për tre pozicione⁸ çmimet e faturuara ishin më të larta se çmimet e kontraktuara, si rezultat janë paguar rreth 1,065€ më shumë se që është dashur; dhe
- Te kontrata “Ndërtimi i shkollës së mesme të artit Odhise Paskali”, përmes ekzaminimit fizik kemi verifikuar se furnizimi me material dhe punimi i shkallëve metalike të kombinuara me dru nuk ishte realizuar edhe pse pagesa ishte lëshuar duke u bazuar në situacionin për pranimin e punëve. Sipas menaxherëve të kontratës pozicionet janë të përfshira me një çmim dhe se nuk ka pasur mundësi që të bëhet ndalja e pagesës në mënyrë të veçantë për shkallët dhe punimi i shkallëve do të bëhet pasi që të përfundojnë të gjitha punët tjera të vrazhda në objekt për shkak të mos dëmtimit të tyre gjatë realizimit të punimeve.

Kjo gjendje ishte për shkak të neglizhencës/pakujdesisë së menaxherëve të kontratave dhe çertifikuesit në aplikimin e kontrolleve efektive në shpenzimin e parasë publike. Duhet theksuar se komuna pas vërejtjeve tona ka marrë masat e nevojshme dhe është dakorduar me operatorët ekonomik për kthimin e parasë publike në buxhetin e komunës.

Rreziku Neglizhenca/pakujdesia e menaxherëve të kontratave dhe çertifikuesit në aplikimin e kontrolleve mund të rezultojë me pagesa të parregullta dhe shton rrezikun për keqpërdorimin e parasë publike.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave dhe çertifikuesi aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm sipas çmimeve të kontraktuara dhe punëve/furnizimeve të realizuara. Po ashtu, për gabimet financiare të identifikuara, komuna duhet të sigurohet se do të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës apo bëhet ndalesa në pagesat e radhës gjatë realizimit të këtyre kontratave.

⁸ Pozicioni A3.1 (çmimi i kontraktuar 0.65€ - çmimi i faturuar 0.69€); pozicioni A4.1 (çmimi i kontraktuar 60€ - çmimi i faturuar 94.8€); dhe pozicioni A6.1 (çmimi i kontraktuar 1.25€ - çmimi i faturuar 1.30€);

Çështja A5 - Ndryshime të sasive të paramasës për kontratat jo kornizë pa aprovimin e ZKA

Gjetja Ndryshimet e sasive lejohen te kontratat kornizë. Ne kemi vërejtur tri (3) kontrata⁹ jo kornizë në të cilat kishte pasur devijime apo ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke i rritur/zvogëluar mbi 10% sasinë e kontraktuar, por pa ndryshuar çmimin total të kontratës. Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga ZKA ashtu siç kërkohet me nenet 61.21, 61.22 dhe 61.23 të rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik.

Duhet theksuar se menaxherët e projekteve nuk ishin në njohuri për kërkesat ligjore për prokurimin publik lidhur me aprovimet e nevojshme për ndryshimin e kontratave.

Rreziku Ndryshimi i paramasës dhe paralogarisë së kontraktuar pa aprovimin e zyrës së prokurimit dhe ZKA-së shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë dhe rrezikon që për shkak të ndryshimit të kushteve të kontratës nuk është përzgjedhur operatori më i lirë.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë pajisur me njohuri lidhur me kërkesat specifike për prokurim publik, dhe raportohet për çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës. Po ashtu, çdo ndryshim në kushtet e kontratës duhet të arsyetohet dhe aprovohet nga zyra e prokurimit dhe ZKA.

⁹ 1. Asfaltimin e rrugëve Hysni Rama, Mihajlo Pupin 2. "Sinjalizimin horizontal dhe vertikal në rrugët e komunës së Pejës"; 3. Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve në hyrje të qytetit në maxhistralen Pejë-Prishtinë"

Çështja A6 - Mungesa e projektit ekzekutiv dhe planeve për menaxhimin e kontratave**Gjetja**

Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten. Ne kemi vërejtur se:

- Në 22 kontrata pune të nënshkruara komuna nuk kishte hartuar projekt ekzekutiv, por kishte iniciuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Komuna nuk kishte kapacitete të brendshme e as kompani të kontraktuar për hartimin e projekteve ekzekutive. Vetëm në rastet e ndërtimeve specifike janë shpallë/kontraktuar projektet ekzekutive. Mungesa e projekteve kryesisht ishte te asfaltimi i rrugëve dhe sipas zyrtarëve të komunës kjo ishte për shkak të mungesës së mjeteve financiare ku sipas tyre hartimi i projekteve ekzekutive po e rritë koston e asfaltimit të rrugëve; dhe
- Në 4 kontrata pune kemi evidentuar se nuk ishte hartuar plani për menaxhimin e kontratës siç kërkohet me nenin 61.7 të UOPP-së.

Rreziku

Mungesa e hartimit të projektit ekzekutiv dhe planit krijon hapësirë që projektet të cilat iniciohen vetëm me paramasë dhe parallogari të mos jenë të punuara me profesionalizëm të duhur, vonesa në realizmin e tyre dhe si të tilla mund të kenë kosto shtesë.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me punë të mos iniciohen pa u siguruar se ekziston edhe projekti ekzekutiv. Parapërgatitjet e duhura për një projekt do të kenë efekt në hartimin e specifikimeve të qarta, duke eliminuar pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë. Po ashtu, duhet të hartohen planet për menaxhimin e kontratave.

Çështja A7 - Vonesa në realizimin e kontratave

Gjetja Nga pagesat e testuara kemi evidentuar vonesa në realizimin e punëve si në vijim:

- Në shtatë (7)¹⁰ kontrata të përfunduara kishte vonesa në realizimin e tyre prej 20 ditë kalendarike deri në 10 muaj; dhe
- Në katër (4) kontrata¹¹ tjera të cilat është dashur të përfundonin në vitin 2018, mirëpo ende nuk janë përmbyllur gjatë kohës që në ishëm në ekzekutim të auditimit (prill 2019).

Duhet theksuar se në asnjërin prej këtyre rasteve nuk kishte kërkesë/aprovim për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratave ashtu siç kërkohet nga dosja e tenderit në nenin 17 dhe 18. Po ashtu, nuk kishte aplikim të penaleve.

Sipas menaxherëve të kontratave vonesat në realizimin e kontratave kryesisht ishin për shkak të specifikave të punëve, dëmtimit të vend punimit për shkaqe objektive, zhvillimit të punëve në të njëjtën kohë nga operatorë të ndryshëm, problemeve me banorët lokal, kushteve atmosferike etj.

Rreziku Vonesat në realizimin e kontratave rrisin rrezikun që obligimet të barten në fund të vitit, dhe të cilat pastaj do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues dhe krejt kjo të reflektojë edhe në arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave në raportet e tyre ofrojnë informata të mjaftueshme rreth ecurisë së zbatimit të kontratave dhe të formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të justifikuar nga ana e Komunës. Po ashtu, duhet të shtohen masat e kontrollit dhe në rastet kur ka vonesa të pa arsyetuara të aplikohen penalet për ditët në vonesë.

10 Lloti 1 - "Ndërtimi i palestrës të edukatës fizike në sh.f. Lidhja e Prizrenit"; Lloti 2 - Ndërtimi i palestrës të edukatës fizike në sh.f. Dëshmorët e Kombit"; "Vendosja e parketit dhe lyerja në sallën sportive në shkollën fillore në Nabërgjan"; për "Asfaltimi i rrugëve Hysni Rama, Mihajlo Pupin; "Ndërtimin e ndriçimit publik në fshatin Broliq"; "Ndërtimi i shkollës së muzikës Halit Kasapollit punët e vrazhda" dhe "Furnizimin dhe mbjelljen e drunjëve në hyrje të qytetit në maxhistralen Peje-Prishtinë".

Çështja A8 - Mangësi në procedurat e prokurimit

Gjetja

Blerjet përmes prokurimit publik duhet të zhvillohen në pajtim me kërkesat e LPP-së, duke respektuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Ne kemi gjetur se:

- Te kontrata për "Ndërtimin e murit mbrojtës të Lumbardhit nga kombinati i lëkur këpucëve deri te ura në tranzit" në vlerë prej 697,190€, kemi identifikuar se siguria e ekzekutimit nuk e mbulonte periudhën e realizimit të kontratës. Afati për realizimin e kontratës ishte 31.12.2020 ndërsa siguria e ekzekutimit skadon me 31.12.2019; dhe
- Te aktiviteti i prokurimit "Ndërtimi i shkollës fillore të mesme të ulët në fshatin Leshan" nuk ishin përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit/njoftimit për kontratë lidhur me përvojën e punës për stafin profesional, përkatësisht menaxheri i projektit i caktuar nga operatori nuk e ka dëshmuar me kontratë por vetëm me CV edhe atë për 2 vite përvojë pune e jo 3 vite sa ishin kërkuar.

Kjo gjendje ishte si rezultat i neglizhencës së zyrtarëve përkatës në aplikimin e kontrolleve gjatë kryerjes së detyrave të punës.

Rreziku

Në mungesë të sigurimit të plotë të ekzekutimit, AK i ka mundësitë e kufizuara për ta detyruar OE të respektojë kushtet e kontratës dhe rrezikon që kontrata të mos përmbushet. Po ashtu, shpërblimi me kontratë pa u përmbushur kriteret ndikon në anashkalimin e kriteret e vendosura në dosje të tenderit.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit se kriteret janë përmbushur në përputhje të plotë me kërkesat dhe se gjatë procesit të vlerësimit evidentohen dhe parandalohen të gjitha këto mangësi në lidhje me përmbushjen e kriterëve.

11 1. Kontrata për "Asfaltimin e rrugëve në fshatrat Jabllanicë e Leshanit, Kliqinë, dhe Leshan "; 2. "Ndërtimin e ndriçimit publik në disa lagje të qytetit të Pejës-faza e II"; 3. Kontrata për "Ndërtimin e Shkollës së mesme të Artit Odhise Paskali" dhe 4. "Ndërtimin e palestrës sportive në sh.f. në Vitomericë".

Çështja A9 - Mangësi në procesin e përzgjedhjes dhe mbikëqyrjes së marrëveshjes

- Gjetja** Komuna ka financuar me 18,673€ ndërtimin e një depo-frigoriferi në pronën private të një fermeri me qëllim të zgjerimit të kapaciteteve për ngritjen dhe ruajtjen e mjedrës në komunën e Pejës. Marrëveshja ishte arritur për 10 vite ku depo- frigoriferi do të jetë në pronësi të Komunës. Ne kemi vërejtur se:
- Përzgjedhja e përfituesit nuk ishte bërë përmes procedurës së shpalljes publike ashtu siç kërkohet me nenin 12 të Rregullores komunale Nr.01-2017 për ndarjen e subvencioneve, por këtë e kishte bërë bazuar vetëm në kërkesën e fermerit dhe marrëveshjen e tij me disa fermer tjerë kultivues të mjedrës; dhe
 - Marrëveshja e arritur nuk e obligonte përfituesin për të raportuar lidhur me zbatimin e kushteve të marrëveshjes, kërkesë kjo e nenit 13¹² dhe 23¹³ të rregullores komunale. Komuna nuk kishte paraparë ndonjë mekanizëm mbikëqyrës/garantues për zbatimin e kushteve të marrëveshjes.

Rreziku Mos përcaktimi i obligimeve për raportimin e rregullt dhe mungesa e mekanizmave mbikëqyrës/garantues rrezikon që shfrytëzimi i depo-frigoriferit nuk bëhet në pajtim me qëllimin dhe kushtet për të cilat është bërë shpenzimi i parasë publike. Ndërsa mos aplikimi i shpalljes publike e bën procesin jo transparent dhe nuk jep siguri se është arritur marrëveshja me e mirë e mundshme.

Rekomandimi A9 Kryetari të siguroj se do të përtërihet marrëveshja mes komunës dhe përfituesit e cila duhet të përcaktojë obligimet lidhur me raportimin e përfituesit në baza të rregullta, si dhe të përcaktojë ndonjë mekanizëm mbikëqyrës/garantues për të siguruar realizimin e qëllimit dhe kushteve të marrëveshjes. Po ashtu, të sigurohet se për rastet e ngjashme aplikohen procedurat e shpalljes publike.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investime kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

¹² Përcakton se për realizimin e subvencionit duhet të lidhet marrëveshja e cila përcakton te drejtat dhe obligimet e palëve si: qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, mbikëqyrjen, formën e subvencionimit, raportimin etj.

¹³ Përfituesit obligohen që pas përfitimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin përshkrues dhe financiar i cili duhet të ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara dhe aktivitetet që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit

Çështja B3 - Pasojat e pagesave përmes vendimeve gjyqësore-përmbartimore

Gjetja

Neni 39 i LMFPF përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim. Ne kemi gjetur se ishin ekzekutuar pagesa në bazë të vendimeve gjyqësore në vlerë prej 539,411€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 478,284€, kamata për vonesa në pagesë dhe shpenzime procedurale të gjykatës (përmbartimit) ishin 61,126€. Tejkalmi i afatit ligjor prej 30 ditëve në mungesë të buxhetit, ka ndikuar në marrjen e mjeteve nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Kemi testuar dy pagesa të cilat janë ekzekutuar sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimor, si:

- Pagesa prej 20,151€ për “Digjitalizimin e Operatit Kadastral” - prej tyre borxhi kryesor ishte 17,857€, kurse shpenzimet tjera ishin 2,294€; dhe
- Pagesa prej 73,068€¹⁴ për dëmshpërblimin e një nxënëse e cila kishte pësuar lëndime fizike/psikike nga shpërthimi i kalldatorës së ngrohjes qendrore në një shkollë fillore. Prej tyre borxhi kryesor ishte 56,675€, kurse shpenzimet tjera ishin 16,393€.

Në të dy rastet Komuna kishte kundërshtuar kryerjen e pagesave duke u bazuar në arsyet e dhëna megjithatë pretendimet e Komunës ishin të pasuksesshme për faktin që gjykata kishte vendosur jo në favor të Komunës.

Rreziku

Shumat e ekzekutuara të pagesave në bazë të vendimeve gjyqësore krijojnë shpenzime shtesë duke reflektuar në prishjen e bilancit buxhetor dhe rrezikon mos realizim të projekteve të planifikuara dhe zvogëlim të fleksibilitetit në shpenzimet e komunës.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj se do të bëjë një planifikim të mirëfillt të buxhetit, duke forcuar disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë dhe marr masat e duhura për menaxhimin e duhur të obligimeve si dhe evitimin e shpenzimeve shtesë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrimit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1,000€) është 326,838,148€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1,000€) është prezantuar 289,740€.

¹⁴ Për këtë qëllim janë kryer dy pagesa (37,047€ + 36,021€)

Çështja A10 - Mangësi në menaxhimin dhe inventarizimin e pasurive

Gjetja Menaxhimi i pasurive rregullohet me rregulloren nr. 02/2013. Në menaxhimin e pasurive kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Investimeve kapitale në vlerë prej 616,532€, (16¹⁵ pagesa) ishin regjistruar si pasuri në përdorim, përderisa është dashur të regjistroheshin si investim në vijim për arsye se projektet ende ishin në fazën e investimeve/ndërtimeve;
- Investimeve kapitale në vlerë prej 107,345€ (4¹⁶ pagesa) ishin regjistruar si artikuj të ri në regjistrin e pasurive kapitale, ndonëse ato ishin përmirësime të pasurive ekzistuese që do të duhej t'i rritet vlera e pasurisë përkatëse;
- Zyrtari i pasurive kishte regjistruar gabimisht në regjistrin e pasurive kapitale si: 10 aparate për oksigjen prej 4,752€ (vlera e një aparati 475€), furnizim me pelet 1,000€ dhe servisimin e kalldasë prej 130€; dhe
- Komuna në fund të vitit kishte themeluar komisionin për inventarizim, mirëpo kemi verifikuar se procesi i inventarizimit nuk kishte përfshirë shkollat, QKMF-të së bashku me QMF si dhe ambulatat, që nënkupton që inventarizimi nuk ishte i plotë e kjo është në kundërshtim me nenin 19.4.1 të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive

Kjo gjendje ishte për shkak të neglizhencës dhe mungesës së njohurive të zyrtarit të pasurive lidhur me kërkesat e rregullores së pasurive. Po ashtu për shkak se komuna nuk kishte ndonjë rregull/procedurë të brendshme të aprovuar për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë që kërkohej në nenin 4.1 të rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Rreziku Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon komuna, duke shkaktuar mbi apo nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të tyre në pasqyra financiare. Po ashtu, inventarizimi jo i plotë rritë rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet apo tjetërsohet.

Rekomandimi A10 Kryetari duhet të siguroj menaxhim efektiv të pasurive përfshirë edhe inventarizimin e plotë dhe në kohën e duhur me qëllim që regjistri i pasurive të prezantoj gjendjen reale të pasurive, pra që vlera e pasurive të mos jetë e mbivlerësuar e as e nënvlerësuar. Po ashtu, duhet siguruar trajnime adekuate për zyrtarin e pasurive me qëllim që kompetenca të jetë në nivelin e duhur për të shmangur të gjitha paqartësitë me të cilat ballafaqohet zyrtari i pasurive gjatë evidentimit dhe menaxhimit të pasurive.

3.3 Të arkëtueshmet

Komuna ka prezantuar llogari të arkëtueshme në vlerë prej 17,635,880€ që kanë të bëjnë me: tatimin në pronë 10,708,700€, ngarkesa për afarizëm të bizneseve 6,391,030€, kërkesat nga paditë gjyqësore 495,140€, dhënia në shfrytëzim e pasurisë me qira 38,940€ dhe çerdhja e fëmijëve 2,070€.

Çështja B4 – Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Me ligjin për tatimin në pronë janë përcaktuar afatet kohore të pagesave të tatimit. Ne kemi verifikuar se të arkëtueshmet e Komunës krahasuar me vitin paraprak ishin rritur për 1,353,770€, prej tyre rritja më e madhe ishte te tatimi në pronë në vlerë prej 1,293,190€ dhe trendi është në rritje të vazhdueshme. Megjithatë, komuna kishte ndërmarrë veprime përmes përmbaruesve dhe kishte lidhur marrëveshje me konsumatorë për pagesën me këste të borxheve. Efektet në mbledhje e të arkëtueshmeve priten të reflektojnë në vitet në vijim.

Rreziku Niveli i lartë i të arkëtueshmeve dhe jo efikasiteti në mbledhjen e tyre mbeten sfida edhe për periudhën e ardhshme. Mos arketimi i të arkëtueshmeve rrezikon që ato vjetërsohen dhe të bëhen të pa mbledhshëm duke krijuar një humbje të drejtpërdrejtë financiare për Komunën.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.

¹⁵ Ndërtimi i shkollës së mesme Odhise Paskali 76,154€. ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Leshan 74,060€ dhe 61,257€, asfaltimin e disa rrugëve dhe rrugicave në qytetin e Pejës 69,512€ dhe 30,688€, ndërtimi i palestrës në shkollën fillore në Vitomericë 45,028€, 18,354€ dhe 16,711€, ndërtimi i pendës dhe kanalit për ujitje Gllaviqice-Vragoc 20,457€ dhe 15,157€, ndërtimin e murit mbrojtës dhe shëtitores së Lumbardhit nga Patriarkana deri te Ura e Gegajve 50,000€ dhe 16,848€, ndërtimin e rrugës në fshatin Rekë e Allagës 44,809€, 21,796€ dhe 19,950€, ndërtimin e ndriçimit publik në disa lagje të qytetit të Pejës¹⁶ 35,751€;

¹⁶ Mirëmbajtja verore e rrugëve 69,324€; Mirëmbajtja e shkollave 19,913€; Vendosija e parketit në sallën sportive 16,332€ dhe Rregullimi i sporteleve të administratës 1,776€.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve e prezantuar në pasqyra financiare në fund të vitit 2018 ishte 853,050€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna.

Çështja B5 - Raportimi i pjesshëm dhe vonesa në pagesën e faturave të papaguara

Gjetja Neni 5.2 i Rregullës financiare nr. 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore thotë: "Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në MF - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara. Ne kemi vërejtur se:

Gjatë vitit 2018 komuna kishte raportuar vetëm për janar, qershor, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor në MF-Thesar.

Neni 39 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike përcakton afatin e pagesës brenda 30 ditëve nga pranimi i faturës. Në 12 mostra të testuara me vlerë prej 414,629€ kemi identifikuar vonesa në pagesa prej 9 deri në 160 ditë.

Kjo gjendje ishte për shkak të neglizhences së zyrtarit përgjegjës për raportimin e obligimeve të papaguara dhe sipas tij për shkak të disa problemeve softwareike që ka rezultuar me humbjen e shënimeve elektronike për faturat e pranuar.

Rreziku Mos raportimi i rregullt i obligimeve në raportet mujore përveç anashkalimit të rregullave, paraqet edhe pasqyrim jo të drejtë të obligimeve për menaxhmentin dhe të tjerët ndërsa vonesat në pagesën e obligimeve brenda afatit ligjor mund të rezultojë me rritje e obligimeve komunale, mundësinë e përballjes me gjykata dhe implikime buxhetore për vitin fiskal vijues.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurohet se është vendosur disiplinë financiare që mundëson që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës së Pejës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, nuk janë të vendosura.

Komuna kishte hartuar një regjistër të rreziqeve megjithatë ende nuk kishte një monitorim dhe menaxhimi efikas të tyre.

Të gjitha Komunitat janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent e të tjera.

Posedon planin zhvillimor urban dhe atë komunal 2006-2025, megjithatë, ende nuk posedon "Hartën Zonale të Komunës" por vetëm është marrë vendimi për hartimin e saj me datën 21.09.2017, e që deri më tani nuk ka ndodhur hartimi i saj.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm operon me dy auditor. Kishte hartuar planin strategjik, dhe planin vjetor të punës. Komiteti i Auditimit po ashtu ka mbajtur katër takime gjatë vitit 2018.

Nga dhjetë auditimet sa ishin planifikuar, janë realizuar në tërësi. Auditimet kanë mbuluar drejtoritë e ndryshme dhe ishin të fokusuara kryesisht në fushën e shpenzimeve, prokurimit, subvencioneve dhe të hyrave.

Nga gjithsej 37 rekomandimet e dhëna në këto raporte të auditimit të brendshëm 26 ishin zbatuar plotësisht, 6 në proces dhe 5 ishin të pazbatuara. Nga kjo vërehet se ka një progres të mirë në

zbatimin e rekomandimeve dhe në këtë proces nuk kishte munguar edhe mbështetja e komitetit të auditimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja B6 – Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

Gjetja Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Pavarësisht se linjat e llogaridhënies dhe të komunikimit ishin funksionale përmes takimeve të rregullta javore, formati aktual i raportimeve menaxheriale nuk ofron bazë për kontrolle të brendshme efektive meqenëse raportimi me shkrim tek menaxhmenti i lartë bëhet vetëm sipas kërkesës dhe jo në baza të rregullta kohore. Si pasojë e kontrolleve jo të mira janë vërejtur dobësi në fushën e prokurimit, pagesën e shpenzimeve, në regjistrimin e pasurisë si dhe arkëtimin/pagesa e borxheve.

Komuna kishte hartuar një regjistër të rreziqeve ku ishte bërë identifikimi i rreziqeve të pritshme kundrejt objektivave, përcaktimi i mënyrës së menaxhimit të tyre dhe njësitë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme. Megjithatë, nuk ishte monitoruar formalisht menaxhimi i tyre.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, komuna duhet të siguroj monitorim efektiv dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 të Komunës ka rezultuar me 19 rekomandime kryesore. Komuna e Pejës kishte përgatitur planin e veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet e dhëna. Megjithatë, nuk janë marrë veprime të mjaftueshme pasi që plani i veprimit nuk është zbatuar në tërësi dhe mangësitë e njëjta vazhdojnë të përsëriten në disa fusha.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, 11 rekomandime ishin zbatuar plotësisht, një ishte në proces ndërsa gjashtë nuk janë zbatuar ende. Po ashtu një rekomandim ishte i mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi i rekomandimeve
1	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave të paluajtshme për tatimit në pronë duhet të bëhet sipas rregullave, në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese me qëllim të përcaktimit të taksave sipas barrës reale për të gjitha objektet në territorin e komunës.	Menaxhmenti kishte marrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimit.	Rekomandimi i zbatuar
2		Kryetari i komunës duhet të siguroj se janë ndërmarr veprimet e nevojshme për kalkulimin e drejtë të ngarkesave tatimore ndaj taksapaguesit duke aplikuar kriterin e cilësisë së objekteve në përputhjeje me koeficienteve e përcaktuar nga ligjvënësi.	Menaxhmenti kishte marrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimit.	Rekomandimi i zbatuar
3		Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale të bëhet vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave.	Nuk ishte marrë ndonjë veprim.	Rekomandimi pa zbatuar
4	Pagat dhe shtesat	Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet e burimeve njerëzore dhe të sigurojë se me rastin e rekrutimit të stafit të arsimit do të respektohen kriteret e konkursit publik dhe do të pranohen vetëm kandidatët që plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara.	Ne gjatë testimeve nuk kemi identifikuar ndonjë mangësi.	Rekomandimi i zbatuar
5		Kryetari i duhet të sigurojë se të gjitha dosjet e të punësuarve do të kompletohen me dokumentacionin e nevojshëm me qëllim të menaxhimit të stafit dhe matjes së performancës, arritjes së objektivave e cila duhet të rregullohet edhe me një politik specifike të brendshëm për këtë çështje.	Nuk ishte marrë ndonjë veprim.	Rekomandimi pa zbatuar

6	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rast se ka nevojë për të punësuar shtesë në komunë (pozita të rregullta) të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, si dhe të gjitha pagesat për pagat e tyre të kalojnë përmes sistemit të pagave.	Këtë vit nuk kishte tejkalime të afateve të kontratave me MSHV, përderisa rekrutime edhe këtë vit në shumicën e rasteve nuk kishte.	Rekomandi m në proces
7		Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme të cilat sigurojnë se paramasa dhe parallogaria përgatiten nga njësia kërkuese në mënyrë që furnizimet të jenë në përputhje me nevojat reale të institucionit, dhe se përllogaritja e vlerës së kontratës do të bëhet në pajtim me kërkesat e LPP-së.	Ishin marrë veprimet e duhura.	Rekomandi m i zbatuar
8		Kryetari duhet të sigurojnë se me rastin e formimit të komisioneve të ndryshme do të respektohen parimet për ndarjen e detyrave siç parashihet me ligjin në fuqi.	Ishin marrë veprimet e duhura.	Rekomandi m i zbatuar
9		Kryetari duhet të sigurojë që në raste të tilla të specifikohet qartë lloji i drurit me të cilin do të furnizohet komuna në përputhje me nevojat reale.	Ishin marrë veprimet e duhura.	Rekomandi m i zbatuar
10		Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e udhëtimeve paraprakisht do të aprovohet lista e pjesëmarrësve për të siguruar që shpenzimet do të bazohen në dëshmi adekuate dhe të mjaftueshme.	Ishin marrë veprimet e duhura.	Rekomandi m i zbatuar
11		Kryetari të sigurohet se janë duke u zbatuar kërkesat ligjore të prokurimit tërësisht dhe nuk do të praktikohet në asnjë rast të vetëm vazhdimi i kontratave publike kornizë, kërkesë e LPP-së.	Ishin marrë veprimet e duhura.	Rekomandi m i zbatuar
12		Kryetari duhet të sigurojë se në pranimin e furnizimeve përfshihet edhe stafi i institucioneve	Menaxhmenti kishte marrë veprimet e	Rekomandi m i zbatuar

		relevante për të siguruar dëshmi dhe informata mbi sasinë e furnizimeve të kryera.	duhura për zbatimin e rekomandimit.	
13	Subvencione dhe transfere	Kryetari duhet të sigurojë se përfituesit e subvencioneve raportojnë për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve, dhe në rastet kur mjetet nuk shfrytëzohen për qëllimin e dhënë të ndërmerren masa ligjore ndaj përfituesve të subvencioneve.	Ishin marrë masa nga menaxhmenti, përfituesit raportojnë për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve.	Rekomandimi zbatuar
14	Çështjet e përbashkëta për mallrat /shërbimet si dhe investimet Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë e detajuar për shkaqet e ekzekutimit të një numri mjaft të madhe të pagesave me vendime gjyqësore dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim eliminimin e pagesave shtesë për vendime gjyqësore.	Mbetet ende sfidë.	Rekomandimi pa zbatuar
15	Të arkëtushmet	Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.	Nuk ishin marrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimit.	Rekomandimi pa zbatuar
16	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.	Nuk ka filluar zbatimi, por nevoja për zbatim është prezentë.	Rekomandimi pa zbatuar
17	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore apo tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-	Rekomandimi mbyllur.	Rekomandimi mbyllur.

		aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.		
18	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë një funksionim efektiv dhe të plotë të Komitetit të Auditimit për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e NJAB-së.	Ishin marrë veprimet e duhura.	Rekomandi m i zbatuar
19	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të monitorojë menaxhimin e rreziqeve dhe të ndërmerre veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.	Ende mbete sfidë.	Rekomandi m i pa zbatuar
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Të gjitha pasuritë jo financiare, duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë, ndërsa pasuritë të cilat nuk janë në pronësi të Komunës duhet të largohen nga regjistrat për të shmangur mbivlerësimin e tyre. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që në PFV 2019 adresohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me gabimet financiare të identifikuar. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		
2	Të hyrat	Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe të siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale të bëhet vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave.		
3		Kryetari duhet të siguroj përmes drejtorit të tatimit në prone se të gjithë pronarët në data bazën e sistemit janë regjistruar sipas numrit identifikues dhe të ndërmarrë veprime shtesë që kjo të bëhet sa më shpejt duke i eliminuar gabimet gjatë procesimit e të dhënave.		

4	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarre hapa konkret për përmirësimin e kontrolleve mbi dosjet e personelit, në mënyrë që të gjitha dosjet të jenë kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm, deri në fund të vitit me qëllim të menaxhimit të stafit dhe matjes së performancës
5	Mallra dhe shërbime	Kryetari, duhet të siguroj ndërprerjen e një praktike të tillë të angazhimeve pa procedura të rekrutimit. Po ashtu, komuna për pozitat e rregullta të punës për të cilat ka nevoja afatgjata kërkesat t'i adresoj me rastin e planifikimit buxhetor, dhe t'i trajtoj dhe diskutoj me MF.
6	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë planifikimi i drejtë i buxhetit sipas nevojave dhe të sigurojë se në PIP vendosën vetëm ato projekte kapitale për të cilat sigurohet se kanë të bëjnë me përvetësimin e pasurisë për nevojat e komunës. Planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.
7	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj se zyrtari çertifikues dhe menaxherët e kontratave aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm sipas çmimeve të kontraktuara dhe punëve/furnizimeve të realizuara. Po ashtu, për gabimet financiare të identifikuar, komuna duhet të sigurohet se do të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës apo bëhet ndalesa në pagesat e radhës gjatë realizimit të këtyre kontratave.
8		Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë pajisur me njohuri lidhur me kërkesat specifike për prokurim publik, dhe raportohet për çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës. Po ashtu, çdo ndryshim në kushtet e kontratës duhet të arsyetohet dhe aprovohet nga zyra e prokurimit dhe ZKA..
9		Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me punë të mos iniciohen pa u siguruar se ekziston edhe projekti ekzekutues. Parapërgatitjet e duhura për një projekt do të kenë ndikim edhe në hartimin e specifikimeve të qarta, por edhe do të eliminohen pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë. Po ashtu, duhet të hartohen planet për menaxhimin e kontratave.
10		Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave në raportet e tyre ofrojnë informata të mjaftueshme rreth ecurisë së implementimit të kontratave dhe të formalizojnë procesin e shtyerjes së afateve kur ato janë të justifikuar nga ana e Komunës. Po ashtu, duhet të shtohen masat e kontrollit dhe në rastet kur ka vonesa të pa arsyetuara të aplikohen penalet për ditët në vonesë
11		Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit se kriteret janë përmbushur në përputhje të plotë me kërkesat dhe se gjatë procesit të vlerësimit

		evidentohen dhe parandalohen të gjitha këto mangësi në lidhje me përmbushjen e kritereve.
12		Kryetari të siguroj se do të përtërihet marrëveshja mes komunës dhe përfituesit e cila duhet të përcaktojë obligimet lidhur me raportimin e përfituesit në baza të rregullta, si dhe të përcaktojë ndonjë mekanizim mbikëqyrës/garantues për të siguruar realizimin e qëllimit dhe kushteve të marrëveshjes. Po ashtu, të sigurohet se për rastet e ngjashme aplikohen procedurat e shpalljes publike.
13	Çështjet e përbashkëta për mallrat shërbimet dhe investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se do të bëj një planifikim të mirëfilltë të buxhetit, duke forcuar disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë dhe marr masat e duhura për menaxhimin e duhur të obligimeve si dhe evitimin e shpenzimeve shtesë.
14	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj menaxhim efektiv të pasurive përfshirë edhe inventarizimin e plotë dhe në kohën e duhur me qëllim që regjistri i pasurive të prezantoj gjendjen reale të pasurive, pra që vlera e pasurive të mos jetë e mbivlerësuar e as e nënvlerësuar. Po ashtu, duhet siguruar trajnime adekuate për zyrtarin e pasurive me qëllim që kompetenca të jetë në nivelin e duhur për të shmangur të gjitha paqartësitë me të cilat ballafaqohet zyrtari i pasurive gjatë evidentimit dhe menaxhimit të pasurive.
15	Llogarit e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.
16	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurohet se është vendosur disiplinë financiare që mundëson që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.
17	Raportimi menaxherial, dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmim



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Pejës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Gazmend Muhaxheri

Kryetar i Komunës së Pejës,

Data: 19. Qershor.2019, Pejë,

